

## LICENSIMI

### Deklarimi i politikës së licensimit të klubeve të FSHF

Për Federatën Shqiptare të Futbollit zbatimi i sistemit të licensimit të klubeve është dhe mbetet një nga prioritetet kryesore të punës së saj. Është objektivi ynë që të sigurojmë që ky sistem funksionon sic duhet dhe që i gjithë informacioni që ata duan klubet për tu pajisur me licensë është i disponueshëm për ta.

Parimet bazë të sistemit janë pavarësia dhe konfidencialiteti, kjo vecanërisht gjatë procesit të vendim marrjes.

FSHF angazhohet të vërë në zbatim sistemin e licensimit të klubeve sipas rregulloreve të përcaktuara. Kryesore mbetet që klubet të kuptojnë që zbatimi i tyre nuk ka rëndësi vetëm për të siguruar licensen por më së shumti do të ndikojë në mirëfunksionim e vetë klubit.

Për përmirësimin e vazhdueshëm të nivelit të shërbimeve ndaj tyre, si dhe për të rritur efektivitetin e sistemit të licensimit, ne do të kërkojmë që klubet dhe partnerët e jashtëm të jenë sa më pranë që të jetë e mundur dhe të përfshihen në rishikimin vjetor të këtij procesi.

FSHF do të zbatojë një sistem menaxhimi cilësor për licensimin e klubeve dhe do të sigurojë dhe respektojë kërkesat e përcaktuara nga Standarti i Cilësisë së Licensimit të Klubeve (botimi 2012).

FSHF siguron që të gjithë ata të përfshirë në sistemin e licensimit të klubeve janë të trajnuar sic duhet dhe plotësisht të ndërgjegjshëm për detyrat e tyre. Gjithashtu, të gjithë ata që janë të përfshirë në këtë duhet të veprojnë në mënyrë etike dhe të respektojnë vlerat bazë të konfidencialitetit dhe pavarësisë.

FSHF kërkon dhe do kërkojë vazhdimisht që përmes procedurave të arrijë:

- Plotësimin e minimumit të kërkesave të parashtruara në Rregulloren e Licensimit të Klubeve.
- Garantimin dhe ruajtjen e sekretit të klientit
- Garantimin e paanshmërisë së organeve vendimarrëse dhe stafit.
- Garantimin e marrjes së veprime parandaluese për shmangien e problemeve.
- Garantimin e trajtimit me eficensë të opinioneve, sugjerimeve dhe ankesave të klubeve.

Duhet të sigurojmë më tej që të gjithë ata që janë të përfshirë në sistem të marrin informacionet e nevojshme, të trajnohen dhe ndërgjegjesohen për detyrat e tyre.

Bashkëpunimi, ndihmesa si dhe marrja në konsideratë e ankesave dhe sugjerimeve të klubeve do të mbetet një nga detyrat tona më të rëndësishme. Do të punojmë për përmirësimin e vazhdueshëm e sistemit duke përdorur metoda dhe shembuj nga homologët tanë në federatat e tjera europiane.

Organizimi ligjor i klubeve të futbollit, përmirësimi i komunikimit me klubet dhe kualifikimi i stafit të tyre do të mbetet prioriteti ynë kryesor. Gjithashtu FSHF do të fokusohet në përmirësimin e infrastrukturës dhe arritjen e standarteve bazë të saj. Ky objektivi bëhet i realizueshëm nëse do t'i referohemi dhe projekteve të federatës lidhur me përmirësimin e terreneve të lojës në shumë stadione të vendit.

### Federata Shqiptare e Futbollit

Shtator 2017